

## GRETA BARDELI



**Datëlindja:** 12.4.1980

**Vendlindja:** Shkodër

**E-mail:** Greta.Bardeli@parlament.al

### **Jetëshkrimi:**

Ka përfunduar studimet në jurisprudencë pranë universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, si edhe masterin shkencor “E drejta ndërkombëtare”.

Pas përfundimit të studimeve për disa vite ka punuar si pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë në universitetin në të cilin është diplomuar në lëndën “E drejtë kontraktuale”.

Mban titullin “Doktor i shkencave” nga Universiteti European i Tiranës, ku ka mbrojtur temën “E drejta e bashkimit familjar dhe mbrojtja e saj në BE dhe Shqipëri”.

Ka mbajtur disa pozicione, si: anëtare e këshillit të Bashkisë Shkodër dhe kryetare e këshillit të qarkut Shkodër. Gjithashtu, është zëvendëskryetare e Partisë Demokratike, dega Shkodër, dhe anëtare e Këshillit Kombëtar të PDSH-së.

Ka disa angazhime ndërkombëtare, si: zëvendëspresidente dhe presidente e *task-force-s* për EUSAIR-in, anëtare e Komitetit Drejtues EuroRajoni Adriatiko-Jonian dhe ka qenë pjesëmarrëse aktive e takimeve të nivelit të lartë të rajoneve të mesdheut dhe BE-së.

Është mandatuar për herë të parë si deputete e Kuvendit të Shqipërisë për qarkun e Shkodrës në zgjedhjet parlamentare të zhvilluar në prill 2021.